

VENDIM
Nr. 39, datë 18.3.2015

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.3.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 155, datë 29.12.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë: *“Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do të shtrijë efektet deri në datën 30.6.2015”*.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti